



Prishtinë, 04.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1404_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2209_07_21** të dt. 23.07.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 20.08.2021;
- Kundërshtimin e KESCO-s të dt. 18.08.2021;

në seancën e mbajtur më datë 04.10.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.H, nga Komuna e Lipjanit, si dhe kundërshtimi i KESCO-s, si të pabazuara.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2209_07_21, i datës 23.07.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 23.07.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2209_07_21 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit F.H dhe e ka obliguar të licencuarin KESCO që konsumatorit t'i korrigjoj faturën e shërbimeve të dt. 24.04.2018, duke e ngarkuar konsumatorin vetëm me taksën për rritje të fuqisë P=5 kW dhe TVSH, por duke e shkarkuar konsumatorin nga taksa për kyçje prej 40 EUR.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori F.H brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Vërtetim i gabuar i gjendjes faktike, sepse ora regjistruese për të cilën është ngarkuar, ka qenë e regjistruar kohë më parë dhe është bërë kërkesa për ndërrimin e tarifës nga ajo e amvisërisë në atë afariste.
- Tarifa në shumën prej 160 EUR nuk ka bazë ligjore dhe se ky vendim do të sjell pasoja të dëmshme në procesin e afarizmit të cilin e zhvillon konsumatori.
- Arsyetimi është i paqëndrueshëm dhe si i tillë nuk mbështetet në asnjë provë materiale dhe ka kërkuar që të shkarkohet nga pagesa për të cilën është faturuar.

Po ashtu, të pakënaqur me Vendimin e DMK-së, brenda afatit ligjor kanë paraqitur Kundërshtim edhe përfaqësuesit e ndërmarrjes KESCO, me pretendimet si në vijim:



- Faturimi i shërbimeve, i bërë më datë 24.04.2018 në vlerë prej 165.20 EUR është konform metodologjisë së taksave për kyçje dhe në përputhje të plotë me metodologjinë tarifore të miratuar nga ZRrE.
- Konsumatori ka pasur fuqi angazhuese për 10 kW dhe për faturim ishin 7 kW për rritje të fuqisë angazhuese.
- KESCO kërkon nga Bordi i ZRrE-së që ta pezulloj vendimin e DMK me nr. ZRrE/DMK_V_2209_07_21 të dt. 23.07.2021, për konsumatorin F.H.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 04.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, pretendimet e konsumatorit F.H dhe të ndërmarrjes KESCO si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se kemi të bëjmë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ZRrE thekson se pasi që ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës, si Procesverbalin e inspektimit të dt. 07.02.2018, faturën e dt. 24.04.2018, ankesën e konsumatorit të dt. 11.06.2018, Përgjigjen e KESCO të dt. 21.06.2018, ankesën e konsumatorit në DMK të dt. 24.04.2019, Vendimin e DMK-së të dt. 23.07.2021, ankesën e konsumatorit për Bordin e ZRrE-së të dt. 20.08.2021 dhe Kundërshtimin e KESCO-s të dt. 18.08.2021, ka vërtetuar se nuk është kontestues fakti se punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë evidentuar në procesverbal se që konsumatorit duhet t'i ndërrohet grupi tarifor 5 (konsumator familjar – 4/02) në grupin tarifor 4 (konsumator jo familjar – 7/02), për shkak se kemi të bëjmë me veprimtari të biznesit.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës Bordi ka vërtetuar se KESCO ka vepruar në përputhje me Procedurën Lidhëse, por që në rastin e konsumatorit mbetet për t'u paguar vetëm tarifa për rritje të kapacitetit P=5 kV (5*20 EUR), si dhe TVSH, dhe konsumatori duhet të lirohet nga taksa prej 40 EUR për kyçje në rrjetin tre fazorë, sepse njehsori elektrik ka qenë i kyçur.

Pretendimi tjetër se fatura me nr. 903-DFE18S169240 e dt. 24.04.2018 në vlerë prej 165.20 EUR, nuk ka bazë ligjore, si i tillë nuk qëndron, pasi që siç edhe është sqaruar në vendimin kontestues konsumatori është ngarkuar me taksën për shërbime për rritje të fuqisë, e cila ka përmbajtur 100 EUR – për PPE në sistemin tre fazor, 40 EUR lidhje në rrjetin elektrik dhe 25.20 EUR TVSh. Për më tepër, një procedurë e tillë është e përcaktuar në mënyrë shprehimore në “Procedurat e Shërbimit të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes dhe Çmimet” të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, e aprovuar nga ZRrE.

Andaj, siç edhe mund të shihet më lart, konsumatori nuk ka ofruar asnjë argument relevant me të cilin do të mund të kontestohet ligjshmëria e vendimit të DMK-së, si organ i shkallës së parë në ZRrE.

Bordi i ZRrE-së, gjithashtu ka analizuar me kujdes edhe pretendimet e ndërmarrjes KESCO dhe thekson se si të tilla janë të paqëndrueshme dhe të pa mbështetura në provat materiale. Për më tepër, pretendimet e tyre janë në kundërshtim me Përgjigjen e lëshuar nga vet KESCO ndaj konsumatorit e dt. 21.06.2018, në të cilën në mënyrë decisive paraqitet si në vijim: *“Në bazë të këtyre fakteve, është faturuar diferenca e fuqisë së angazhuar në amvisëri në komercial, gjegjësisht 5 kW, sepse fuqia e angazhuar në amvisëri është 5 kW, dhe se fatura është në përputhje me dispozita ligjore”*. Po ashtu, edhe fatura e kontestuar nga konsumatori e dt. 24.04.2018, e lëshuar nga ndërmarrja KESCO, e paraqet sasinë në 5 kW. Pra, pretendimi që diferenca shtesë për fuqi angazhuese është 7 KW e jo 5 KW, është në kundërshtim me vlerësimin e bërë nga vet KESCO dhe faturën e kontestuar po ashtu.

Duke u bazuar në nenin 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, në mënyrë shprehimore parashihet si në vijim: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët*



të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njezhori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”, Bordi thekson se konsumatori duhet të faturohet për energjinë që e shpenzon dhe për shërbimet tjera të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi, mirëpo jo të ngarkohet dy herë për shërbimin të cilin veçse ka qenë duke e shfrytëzuar, në rastin konkret, për taksën e kyçjes në rrjet.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 04.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit F.H. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar